



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

02 Nr. _____ /2026 | Dt. 16 /02 /2026

DRAFT PLANI VJETOR I PUNËS I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2026

HYRJE

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBS) funksionon duke u bazuar në udhëzimin administrative Nr. 027/2012 MPB - 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe vendimit për Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi nga Kuvendi Komunal Deçan me Nr. 01.Nr.II-3 të themeluar me 30.12.2021.

Roli i KKSBS-së, është organ këshillues - konsultues për çështje të sigurisë, me përfaqësim të gjerë të të gjitha bashkësive të Komunës, si dhe përfaqësues të Shoqërisë civile, duke marrë parasysh edhe kriteret e përfaqësimit gjinor, i cili në bashkëpunim me policinë shqyrton të gjitha çështjet e sigurisë në bashkësi në të mirë të të gjithë qytetarëve të Komunës. KKSBS-ja ka si synim identifikimin e dukurive negative që mund të prishin sigurinë publike, parandalimin e veprimeve të cilat kërcënojnë sigurinë në bashkësi, eliminimin e dukurive që lidhen me natyrën e krimit, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme, si dhe krijimin e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me të gjitha komunitetet që jetojnë në territorin e Komunës së Deçanit.

Qëllimi i KKSBS-së, është kryesisht i përqendruar në aktivitete për çështje të sigurisë, në bashkëpunim me policinë, qytetarët, institucionet arsimore dhe institucionet tjera të sigurisë, bashkësitë fetare dhe përfaqësuesit e Shoqërisë civile për të identifikuar dhe shqyrtuar çështjet që lidhen me problemet e sigurisë në bashkësi, me synim të zgjidhjes konkrete të këtyre problemeve.

Plani vjetor i punës së KKSB-se për vitin 2026 përcakton objektivat dhe aktivitetet të cilat do të ushtrohen nga anëtarët e KKSB-së me qëllim të realizimit të detyrave të parapara sipas Udhëzimit Administrativ. KKSB-ja nuk do të kufizohet vetëm në detyrat e përcaktuara në këtë plan por do të jetë aktiv edhe në jetën e përditshme të qytetarëve, do të identifikoj dhe trajtoj problemet e përgjithshme të qytetarëve.

Objektivat KKSB-së:

- ❖ Mbajtja e të gjitha takimeve të rregullta për vitin 2026;
- ❖ Rritja e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e sigurisë;
- ❖ Monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së sigurisë në Komunën e Deçanit;
- ❖ Identifikimi i dukurive negative që mund të prishin sigurinë publike;
- ❖ Parandalimi i veprimeve të cilat kërcënojnë sigurinë në bashkësi;
- ❖ Ndërtimi i besimit dhe bashkëpunimit në mes Komunës së Deçanit. Policisë së Kosovës, institucioneve tjera të sigurisë dhe qytetarëve në nivelin sa më të lartë që është e mundur me qëllim të rritjes së sigurisë në bashkësi;
- ❖ Rritja e sigurisë në shkolla në të gjitha nivelet;
- ❖ Të gjitha diskutimet, vërejtjet, sugjerimet dhe kërkesat e parashtruara nga pjesëmarrësit e KKSB-së, të zgjidhen në afatin sa më të shpejtë që është e mundur.

Nr.	Muaji	Agjenda	Folësit/pjesëmarrësit	Parashtruesit e kërkesës	Aprovoi:	Informon	Vërejtje
1.	MARS	<ol style="list-style-type: none"> Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, informatë nga Policia e Kosovës; Situata në Komunë, me ndriçim, parkingje, mbeturina dhe pastrim të rrugëve, trotuareve dhe hapësirave tjera nga dëbora; Situata me qentë endacak në Komunën e Deçanit Të ndryshme 	<p>Kryetari i Komunës dhe koordinatori</p> <p>Komandanti i stacionit policor të Deçanit</p> <p>Drejtorja e Arsimit</p> <p>Drejtorja e MSHSHP</p>	<p>Koordinatori i KKSB-së, në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe anëtarët e KKSB-së</p>	Kryetari i Komunës	Kuvendin Komunal të Deçanit	
2.	PRILL	<ol style="list-style-type: none"> Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, informatë nga Policia e Kosovës; Situata me zjarre pranverore, fushore dhe malore. Të ndryshme 	<p>Kryetari i Komunës dhe koordinatori</p> <p>Komandanti i stacionit policor të Deçanit</p> <p>Drejtorja MSHSHP</p>	<p>Koordinatori i KKSB-së, në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe anëtarët e KKSB-së</p>	Kryetari i Komunës	Kuvendin Komunal të Deçanit	

3.	QERSHOR	<ol style="list-style-type: none"> 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, informatë nga Policia e Kosovës; 3. Përgatitja për pritjen e bashkatdhetarëve gjatë sezonit të pushimeve. 4. Të ndryshme 	<p>Kryetari i Komunës dhe koordinatori</p> <p>Komandanti i stacionit policor të Deçanit</p> <p>Drejtorja MSHSHP</p>	<p>Koordinatori i KKSB-së, në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe anëtarët e KKSB-së</p>	<p>Kryetari i Komunës</p>	<p>Kuvendin Komunal të Deçanit</p>	
4.	SHTATOR	<ol style="list-style-type: none"> 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, informatë nga Policia e Kosovës; 3. Fillimi i vitit të ri shkollor, vlerësimi i sigurisë në shkolla dhe identifikimi i problemeve e rreziqeve të mundshme 4. Të ndryshme 	<p>Kryetari i Komunës dhe koordinatori</p> <p>Komandanti i stacionit policor të Deçanit</p> <p>Drejtorja e Arsimit</p>	<p>Koordinatori i KKSB-së, në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe anëtarët e KKSB-së</p>	<p>Kryetari i Komunës</p>	<p>Kuvendin Komunal të Deçanit</p>	

5.	TETOR	<ol style="list-style-type: none"> 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, informatë nga Policia e Kosovës; 3. Aktivitet në bashkëpunim me komunitet 4. Plani operativ për mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve për sezonin e dimrit. 5. Të ndryshme 	<p>Kryetari i Komunës dhe koordinatori</p> <p>Komandanti i stacionit policor të Deçanit</p> <p>Drejtorja MSHSHP</p>	<p>Koordinatori i KKSB-së, në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe anëtarët e KKSB-së</p>	<p>Kryetari i Komunës</p>	<p>Kuvendin Komunal të Deçanit</p>	
6.	DHJETOR	<ol style="list-style-type: none"> 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; 2. Vlerësim mbi çështjen e sigurisë në Komunën e Deçanit, informatë nga Policia e Kosovës; 3. Marrja e masave parandaluese për mënyrën e parandalimit të përdorimit të mjeteve piroteknike gjatë festave të fund vitit 4. Draft plani i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2027 5. Të ndryshme 	<p>Kryetari i Komunës dhe koordinatori</p> <p>Komandanti i stacionit policor të Deçanit</p> <p>Drejtorja MSHSHP</p>	<p>Koordinatori i KKSB-së, në bashkëpunim me Kabinetin e Kryetarit të Komunës dhe anëtarët e KKSB-së</p>	<p>Kryetari i Komunës</p>	<p>Kuvendin Komunal të Deçanit</p>	

Shënim: Në raste të situatave të papritura apo të jashtëzakonshme, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi mund të thirrë mbledhje të menjëhershme.